



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 18.08.2016, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02/2057/16, për zyrtaren e lartë znj. Arta Haxha, Drejtore e Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural ne Komunën e Vushtrrisë për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshem për ekzistimin e konfliktit të interesit, ne ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm të interesit është zhvilluar procedura e paraparë sipas nenit 18.1 dhe 18.2 te ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Pas kërkesës se pranuar nga zyra ligjore e Komunës se Vushtrrisë për te marrë një përgjigje lidhur me pyetjen e ber nga një anëtar i Asamblesë Komunale të Vushtrrisë lidhur me situatën e mundshme të konfliktit të interesit për zyrtaren e lartë ne Komunën e Vushtrrisë znj. Arta Haxha, Drejtore e Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

Pas vlerësimit të kësaj kërkesë është nxjerr vendimi me nr. AKK-03-02-2057/16 për fillimin e shqyrtimit të situatës së mundshme të konfliktit të interesit për zyrtaren e lartë znj. Arta Haxha, Drejtore e Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në Komunën e Vushtrrisë.

Nga kërkesa e marrë është thënë se znj. Arta Haxha, Drejtore e Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural ne Komunën e Vushtrrisë merr pagë edhe nga Komuna edhe nga

projekti për ndërtimin e fabrikës për riciklimin e mbeturinave i cili projekt është në bashkëfinansim me Komunën dhe Komisionin Evropian.

Duke vepruar sipas kompetencave dhe mandatit Agjencia kundër Korrupsionit ka zhvilluar procedurën e paraparë duke njoftuar zyrtaren për fillimin e procedurës për trajtim të situatës së mundshme të konfliktit të Interesit.

AKK, ka ftuar zyrtaren në takim informues për të marrë informata shtesë dhe për ta informuar lidhur me çështjen ngritur .

Gjatë takimit i cili është mbajtur në zyrat e AKK-së zyrtarja e lartë znj. Arta Haxha na ka njoftuar për çështjen e ngritur si dhe na ka ofruar informata shtesë lidhur me projektin në të cilën është emëruar pas kërkesës së bërë nga “Prishtina REA” si partner implementues i projektit “Krijimi i Platformës Ekonomikisht të Qëndrueshme për Mbledhjen dhe Paketimin e Mbeturinave të Riciklueshme në Vushtrri- që të përcaktoj një zyrtar në pozitën e organit mbikëqyrës, andaj me vendim të Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë është emëruar si organ mbikëqyrës për Komunën e Vushtrrisë në projektin e financuar nga Komisioni Evropian dhe Komuna e Vushtrrisë në bazë të Kontratës së Grantit “Shërbimi i jashtëm i Bashkimit Evropian-2014/354-520.

Duke e pyetur znj. Haxha, lidhur me detyrat dhe përgjegjësit e saj si organ mbikëqyrës në këtë projekt ajo na ka njoftuar se : bazuar në vendimin e kryetarit të Komunës së Vushtrrisë si dhe në bazë të përkrahimit të detyrave që rrjedhin nga projekti në fjale ajo ka për obligim :

- a) Të përcjell punët gjatë realizimit të projektit dhe të informoj Kryetarin në baza mujore përmes raporteve me shkrim apo me shpesh nëse kërkohet.
- b) Të siguroj Komunën e Vushtrrisë që të gjitha aktivitetet e projektit implementohen sipas kontratës me Autoritetin Kontraktues dhe marrëveshjet e tjera me partneret e projektit
- c) Të kontrolloj raportet e projektit dhe dokumentet tjera të prodhuara në kuadër të projektit
- d) Të kontrolloj materialet e promovimit të projektit dhe materialet e vizibilitetit.

Ndërsa sipas projektit angazhimi i organit mbikëqyrës në këtë projekt është me orarë të shkurtuar por edhe për shkak të angazhimeve që ka si Drejtore e Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në Komunën e Vushtrrisë

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të ofruar nga zyrtarja znj. Arta Haxha si dhe pas vlerësimit të dokumenteve përcjellëse të siguruara nga Komuna e Vushtrrisë dhe implementuesit të projektit “ Prishtina REA” rrjedh se : angazhimi i znj. Arta Haxha, Drejtore e Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në Komunën e Vushtrrisë si organ mbikëqyrës i emëruar nga Kryetari i Komunës së Vushtrrisë në projektin e financuar nga Komisioni Evropian dhe Komuna e Vushtrrisë “Krijimi i Platformës Ekonomikisht të Qëndrueshme për Mbledhjen dhe Paketimin e Mbeturinave të Riciklueshme në Vushtrri, nuk mund të cilësohet si situatë e Konfliktit të Interesit, apo kufizim në ushtrim të funksionit tjera krahas ushtrimit të funksionit publik të paraparë sipas ligjit Nr.04/L-051 Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

znj. Arta Haxha, Drejtore e Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në Komunën e Vushtrrisë është emëruar me vendim të veçantë nga Kryetari i Komunës së Vushtrrisë sipas mandatit të tij që rrjedh nga neni 13 i Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe neni 67 i Statutit të Komunës së Vushtrrisë, si organ mbikëqyrës në projektin ku Komuna e Vushtrrisë është bashkë financuese e projektit të lartcekur.

Në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi si dhe me atë që u tha më lartë mund të konstatojmë se nuk kemi elemente të gjendjes faktike të konfliktit të interesit apo kufizim në ushtrim të funksionit tjera krahas ushtrimit të funksionit publik të paraparë sipas Ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik për zyrtarët e lartë znj. Arta Haxha, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Hasan Preteni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

